

VENDIM
Nr.1671, datë 24.12.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, (objekt), që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekt, me vlerë 3 125 158 (tre milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, dhe me vlerë 2 984 015 (dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, të përballohet nga zëri “shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2008 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

7. Pronarët, që shpronësohen, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrisë përkatëse.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH**

	PRONARI		Z.K.	NR.PAS	OBJEKTI VLERA Lekë	SHËNIME
Gjok	Ndue	Gega	1190	27/7	3125158	Konfirmuar nga ZRPP
Ndrec	Ndue	Gega	1190	27/6	2984015	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali				6109173	